



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 44	2003	Qershor
---------------	-------------	----------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.246, datë 24.4.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Balldre-Piraj, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër.....	1659
Vendim i KM nr.315, datë 24.4.2003	Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe të institucioneve shtetërore.....	1670
Vendim i KM nr.316, datë 24.4.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.78, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje”, i ndryshuar.....	1675
Vendim i KM nr.319, datë 15.5.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 13.1.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hapjeneshkollës pasuniversitare në administrim biznesi” dhe në vendimin nr.588, datë 2.11.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollave pasuniversitare, pranë Universitetit të Tiranës, Universitetit Politeknik, Universitetit Bujqësor dhe Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve”.....	1678
Udhëzim i ME dhe AKP nr.1, datë 9.5.2003	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes”.....	1679

Udhëzim i përbashkët i ME dhe AKP nr.2, datë 9.5.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve në shoqëritë tregtare.....	1690
Udhëzim i ME, MPVD dhe AKP nr.3, datë 30.5.2003	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 13.3.2003 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare”.....	1693
Udhëzim i ME nr.4, datë 11.6.2003	Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore.....	1695
Vendim i KKRT nr.134, datë 30.4.2003	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Alfa”...	1697
Vendim i KKRT nr.135, datë 30.4.2003	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Lushnja”.....	1698
	<i>Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Driza.....</i>	1698
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Qemal Veizi</i>	1698
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Qani Xhemali</i>	1698
	Ndreqje gabimi	1699

V E N D I M
Nr.246, datë 24.4.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR BALLDRE-PIRAJ, PJESË E
SUPERSTRADËS LEZHË-SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Balldre-Piraj, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 240 420 m² tokë/arë, një shtëpi, me sipërfaqe 102 m², nga të cilat 30 m² verandë dhe 72 m² objekt, kultura bujqësore, me një vlerë 3 827 520 dhe 543 000 lekë dru frutorë, në shumën e përgjithshme prej 222 620 286 (dyqind e njëzet e dy milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 1 026 000 (një milionë e njëzet e gjashtë mijë) lekësh.
5. Fondi prej 223 646 286 (dyqind e njëzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe të përfundojë brenda datës 31.5.2003.
7. Pagesat të bëhen pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999.
8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE

QARKU: LEZHE

Listë-pagesa e pronareve qe shpronesohen per shkak te ndertimit te

segmentit rrugor Lezhe-Shkoder

(Seksioni III Balldre - Piraj)sipas V.K.M Nr.246 , date 24/04/2003

Lloji i pasurise se paluajtshme : Toke bujqesore. Ndertese. Nr. 1-238

Z.	K	Nr.	Emri	Pronar	i	Nr.	Toke bujqesore			Kult.buj.+dr. frut.		Ndertese			Vlera ne leke per t'u paguar 100%	Shenime sqaruese
							Sip.	Cmimi	Vlera	Vlera	Vlera	Sip.	Cmimi	Vlera		
						pas.	shpr.	ne	ne	kult.buj.	dru frut.	ne	ne	ne		
							m2	lek/m2	leke	leke	leke	m2	lek/m2	leke		
1	1	Kol	Mirash	Gjoni	349/4		988	900	889200	15808					905008	
8	2	Zef	Ded	Gjoni	349/3		65	900	58500	1040					59540	
7	3	Prel	Zef	Gjoni	348/11		109	900	98100	1744					99844	
3	4	Pashk	Tom	Gjoni	348/12		1121	900	1008900	17936					1026836	
	5	Simon	Ndue	Gjoni	348/13		1674	900	1506600	26784					1533384	
	6	Ndoc	Mirash	Gjoni	307/1		1668	900	1501200	26688					1527888	
	7	Kol	Gjon	Cotaj	308/2		339	900	305100	5424					310524	
G	8	Vasil	Kol	Maci	308/3		1890	900	1701000	30240					1731240	
O	9	Simon	Gjok	Cotaj	308/4		1419	900	1277100	22704					1299804	
C	10	Rrok	Pashuk	Cotaj	308/5		479	900	431100	7664					438764	
A	11	Ndok	Fran	Cotaj	340/17		750	900	675000	12000	53000				740000	
J	12	Ded	Fran	Cotaj	360/22		2220	900	1998000	35520	100000				2133520	
	13	Viktor	Hil	Nikolla	209/25		150	900	135000	2400					137400	Proces Rregjistrimi
	14	Nikoll	Ndue	Nikolla	209/24		1060	900	954000	16960					970960	Proces Rregjistrimi
	15	Tom	Jak	Kola	209/23		969	900	872100	15504					887604	Proces Rregjistrimi

K	16	Gjin	Jak	Kola	209/22	760	900	684000	12160					696160	Proces Rregjistrimi
	17	Jak	Tom	Kola	209/21	175	900	157500	2800					160300	Proces Rregjistrimi
	18	Gjin	Dod	Kola	209/20	736	900	662400	11776					674176	Proces Rregjistrimi
	19	Nikoll	Gjin	Paloka	209/19	880	900	792000	14080					806080	Proces Rregjistrimi
	20	Shtjefen	Pjeter	Shtjefni	209/18	264	900	237600	4224					241824	Proces Rregjistrimi
	21	Pashk	Mark	Ndoj	209/17	644	900	579600	10304					589904	Proces Rregjistrimi
	22	Ndrec	Mark	Ndoj	209/16	472	900	424800	7552					432352	Proces Rregjistrimi
	23	Pjeter	Gjon	Ndoj	209/15	276	900	248400	4416					252816	Proces Rregjistrimi
	24	Gjon	Mark	Ndoj	209/14	315	900	283500	5040					288540	Proces Rregjistrimi
	25	Hil	Zef	Toma	209/13	330	900	297000	5280					302280	Proces Rregjistrimi
	26	Luigj	Zef	Toma	209/12	528	900	475200	8448					483648	Proces Rregjistrimi
	27	Gasper	Ndue	Frroku	209/11	528	900	475200	8448					483648	Proces Rregjistrimi
	28	Gjergj	Ndue	Pepa	209/10	660	900	594000	10560					604560	Proces Rregjistrimi
	29	Nikoll	Gjon	Koleci	209/9-1	286	900	257400	4576					261976	Proces Rregjistrimi
	30	Luigj	Ndrec	Koleci	209/9	286	900	257400	4576					261976	Proces Rregjistrimi
	31	Mark	Lazer	Koleci	209/8	264	900	237600	4224					241824	Proces Rregjistrimi
	32	Gjin	Lazer	Koleci	209/7	264	900	237600	4224					241824	Proces Rregjistrimi
	33	Mark	Dod	Gjoni	209/6-1	352	900	316800	5632					322432	Pretendim pronesie
	34	Gjok	Kole	Gjoni	209/6	154	900	138600	2464					141064	Proces Rregjistrimi
	35	Kole	Mark	Gjoni	209/5	198	900	178200	3168					181368	Proces Rregjistrimi
	36	Gjergj	Mark	Frroku	209/4	726	900	653400	11616					665016	Proces Rregjistrimi
	37	Ndrec	Pal	Ndoka	209/3	440	900	396000	7040					403040	Proces Rregjistrimi
	38	Ndue	Prec	Preka	209/2	374	900	336600	5984					342584	Proces Rregjistrimi
	39	Zef	Prec	Preka	209/1	408	900	367200	6528					373728	Proces Rregjistrimi
A	40	Prec	Hil	Preka	209/31	172	900	154800	2752					157552	Proces Rregjistrimi
	41	Hil	Prec	Preka	208/29	1050	900	945000	16800					961800	Proces Rregjistrimi

L	42	Ndue	Tom	Tuku	208/28	273	900	245700	4368					250068	Proces Rregjistrimi
	43	Nikoll	Ndue	Tuku	208/27	210	900	189000	3360					192360	Proces Rregjistrimi
	44	Hil	Ndue	Tuku	208/26	630	900	567000	10080					577080	Proces Rregjistrimi
L	45	Pal	Jak	Tuku	208/25	210	900	189000	3360					192360	Proces Rregjistrimi
M	46	Vincens	Pjeter	Coli	208/24	651	900	585900	10416					596316	Proces Rregjistrimi
	47	Shtjefen	Pjeter	Coli	208/23	420	900	378000	6720					384720	Proces Rregjistrimi
	48	Anton	Pjeter	Coli	208/22	315	900	283500	5040					288540	Proces Rregjistrimi
E	49	Luigj	Gaspar	Coli	208/21	735	900	661500	11760					673260	Proces Rregjistrimi
T	50	Hil	Nik	Coli	208/20	546	900	491400	8736					500136	Proces Rregjistrimi
	51	Tonin	Zef	Biba	208/19	210	900	189000	3360					192360	Proces Rregjistrimi
	52	Viktor	Hil	Biba	208/18	126	900	113400	2016					115416	Proces Rregjistrimi
	53	Zef	Hil	Biba	208/17	420	900	378000	6720					384720	Proces Rregjistrimi
	54	Dod	Hil	Biba	208/16	126	900	113400	2016					115416	Proces Rregjistrimi
	55	Mark	Pjeter	Frroku	208/15	588	900	529200	9408					538608	Proces Rregjistrimi
	56	Simon	Zef	Frroku	208/14	420	900	378000	6720					384720	Proces Rregjistrimi
	57	Pjeter	Zef	Frroku	208/13	630	900	567000	10080					577080	Proces Rregjistrimi
	58	Zef	Pjeter	Frroku	208/12	894	900	804600	14304					818904	Proces Rregjistrimi
	59	Mark	Bib	Kola	208/11	660	900	594000	10560					604560	Proces Rregjistrimi
	60	Nikoll	Ndue	Kola	208/10	399	900	359100	6384					365484	Proces Rregjistrimi
	61	Gjok	Dod	Kola	208/9	399	900	359100	6384					365484	Proces Rregjistrimi
	62	Zef	Lorenc	Kola	208/8	323	900	290700	5168					295868	Proces Rregjistrimi
	63	Lorenc	Ded	Kola	208/7	340	900	306000	5440					311440	Proces Rregjistrimi
	64	Gjok	Lazer	Gjoka	208/6	378	900	340200	6048					346248	Proces Rregjistrimi
	65	Zef	Gjok	Gjoka	208/5	168	900	151200	2688					153888	Proces Rregjistrimi
	66	Llesh	Gjok	Gjoka	208/4	378	900	340200	6048					346248	Proces Rregjistrimi
	67	Ndrec	Gjin	Gega	208/3	315	900	283500	5040					288540	Proces Rregjistrimi

	68	Gjon	Pal	Gega	208/2	399	900	359100	6384					365484	Proces regjistrimi
	69	Mark	Pal	Gega	208/1	546	900	491400	8736					500136	Proces regjistrimi
	70	I paidentifikuar			205	3940	900	3546000	63040					3609040	Pretendim pronesie
	71	I paidentifikuar			205	3480	900	3132000	55680					3187680	Pretendim pronesie
	72	Shtjefen		Gaspri	204/5-1	1224	900	1101600	19584					1121184	Proces regjistrimi
	73	Viktor		Gaspri	204/5-2	2958	900	2662200	47328					2709528	Proces regjistrimi
	74	Rrok	Lazer	Marku	213/14	1200	900	1080000	19200					1099200	
	75	Taze	Mark	Marku	213/13	1100	900	990000	17600					1007600	
	76	Luigj	Zef	Marku	213/12	567	900	510300	9072					519372	
	77	Nik	Zef	Marku	213/11	483	900	434700	7728					442428	
	78	Vlash	Lazer	Hila	213/10	525	900	472500	8400					480900	
	79	Vlash	Lazer	Hila	213/9	525	900	472500	8400					480900	
	80	Lin	Dede	Ndoci	213/8	1694	900	1524600	27104					1551704	
	81	Nikoll	Rrok	Frani	213/7	1533	900	1379700	24528					1404228	
2	82	Salvator	Gjergj	Ndoci	213/6	588	900	529200	9408					538608	
	83	Gjergj	Gjon	Ndoci	213/5	525	900	472500	8400					480900	
9	84	Zef	Gjergj	Ndoci	213/4	546	900	491400	8736					500136	
	85	Kin	Ejell	Zefi	213/3	1386	900	1247400	22176					1269576	
6	86	Mark	Pjeter	Hila	213/2	1722	900	1549800	27552					1577352	
	87	Simon	Hile	Hila	213/1	2090	900	1881000	33440					1914440	
4	88	Ndue	Zek	Marku	202/1	446	900	401400	7136					408536	
	89	Ndrek	Dede	Marku	202/2	345	900	310500	5520					316020	
	90	Pjeter	Luigj	Zefi	202/3	968	900	871200	15488					886688	
	91	Gjin	Ndrek	Zefi	202/4	1200	900	1080000		360000				1440000	
	92	Ndue	Filip	Zefi	202/5	1127	900	1014300	18032					1032332	
	93	Zek	Ejell	Zefi	202/6	338	900	304200	5408					309608	

P	94	Gjok	Filip	Zefi	202/7	1495	900	1345500	23920					1369420	
	95	Ndue	Hil	Marku	202/8	1495	900	1345500	23920					1369420	
	96	Ndue	Mark	Gega	202/9	1495	900	1345500	23920					1369420	
	97	Engjell	Vas	Ndoci	202/10	1104	900	993600	17664					1011264	
I	98	Ndue	Mark	Gega	202/11	552	900	496800	8832					505632	
	99	Pjeter	Prek	Ndreu	203/11	1334	900	1200600	21344					1221944	
R	100	Lula	Filip	Toma	203/10	414	900	372600	6624					379224	Konfirmim nga Z.R.P.P
	101	Nikoll	Zef	Marku	203/15	874	900	786600	13984					800584	
A	102	Gac	Fran	Frani	203/14	3013	900	2711700	48208					2759908	
	103	Preke	Gjon	Gjergji	203/8	644	900	579600	10304					589904	
J	104	Gjon	Zef	Marku	203/7	736	900	662400	11776					674176	
	105	Serafin	Ndue	Deda	203/6	690	900	621000	11040					632040	
	106	Ndue	Pal	Leci	203/5	2070	900	1863000	33120					1896120	
	107	Ndue	Filip	Zefi	203/4	920	900	828000	14720					842720	
	108	Kin	Ejell	Zefi	203/3	644	900	579600	10304					589904	
	109	Ndrek	Bardh	Zefi	203/2	506	900	455400	8096					463496	
	110	Gac	Gjergj	Zefi	203/1	666	900	599400	10656					610056	Konfirmim nga Z.R.P.P
	111	Zef	Shtefen	Ndreca	174/19	658	900	592200	10528					602728	
1	112	Shtefen	Zek	Ndreca	174/18	319	900	287100	5104					292204	
	113	Rrok	Ndue	Mhilli	174/16	506	900	455400	8096					463496	
2	114	Ded	Rrok	Mhilli	174/15	690	900	621000	11040					632040	
0	115	Hil	Vas	Mhilli	174/14	276	900	248400	4416					252816	
	116	Vas	Ndue	Mhilli	174/13	621	900	558900	9936					568836	
	117	Gac	Lazer	Lemezhi	174/10	240	900	216000	3840					219840	
	118	Lazer	Gac	Lemezhi	174/11	312	900	280800	4992					285792	

	119	Ndue	Gac	Lemezhi	174/12	351	900	315900	5616					321516	
	120	Palok	Mark	Voka	173/8	630	900	567000	10080					577080	
	121	Vlash	Pjeter	Vokaj	173/7	280	900	252000	4480					256480	Konfirmim nga Z.R.P.P
	122	Rrok	Shtjefen	Lleshi	173/6	1050	900	945000	16800					961800	
	123	Ndrek	Pashuk	Voka	173/5	1320	900	1188000	21120					1209120	
	124	Pjeter	Zef	Vokaj	173/4	902	900	811800	14432					826232	Konfirmim nga Z.R.P.P
	125	Shtjefen	Kin	Gjoka	173/3	1470	900	1323000	23520					1346520	
	126	Gjergj	Kin	Gjoka	173/2	945	900	850500	15120					865620	
	127	Kin	Ndoc	Gjoka	173/1	483	900	434700	7728					442428	
B	128	Hil	Zef	Tuku	166/12	1254	900	1128600	20064					1148664	
L	129	Ndue	Lek	Gega	166/11	1323	900	1190700	21168					1211868	
I	130	Ndrek	Dod	Gega	166/10	1512	900	1360800	24192					1384992	
N	131	Mati	Gjok	Gega	166/9	420	900	378000	6720					384720	
I	132	Dod	Mati	Gega	166/8	693	900	623700	11088					634788	
S	133	Gjok	Dod	Gega	166/7	1260	900	1134000	20160					1154160	
H	134	Gjon	Shtjefen	Zhuba	166/6	946	900	851400	15136					866536	
T	135	Zek	Kol	Gjeka	166/5	1804	900	1623600	28864					1652464	
	136	Rrok	Mark	Sallaku	166/3	1408	900	1267200	22528					1289728	
	137	Pal	Serafin	Shtjefni	93/8	1403	900	1262700	22448					1285148	
	138	Serafin	Vlash	Shtjefni	93/11	1012	900	910800	16192					926992	
	139	Ndue	Serafin	Shtjefni	93/9	1541	900	1386900	24656					1411556	
	140	Simon	Serafin	Shtjefni	93/10	2461	900	2214900	39376					2254276	
	141	Mark	Prek	Matia	93/12	1426	900	1283400	22816					1306216	
	142	Gjergj	Bardh	Matia	93/13	2530	900	2277000	40480					2317480	
	143	Filip	Geg	Gjoka	91/10	4444	900	3999600	71104					4070704	

1	144	Vlash	Ndoc	Skandaj	91/9	2200	900	1980000	35200					2015200	
0	145	Ndoc	Bib	Skandaj	91/8	1144	900	1029600	18304					1047904	
9	146	Bibe	Dod	Skandaj	91/7	946	900	851400	15136					866536	
6	147	Frederik	Ndrec	Skandaj	91/6	1100	900	990000	17600					1007600	
	148	Ndrec	Dod	Skandaj	91/5	1210	900	1089000	19360					1108360	
	149	Gjok	Gjok	Skandaj	91/4	1628	900	1465200	26048					1491248	
	150	Ded	Zef	Skandaj	91/3	682	900	613800	10912					624712	
B	151	Zef	Gjok	Skandaj	91/2	1210	900	1089000	19360					1108360	
A	152	Hile	Bib	Skandaj	91/1	1980	900	1782000	31680					1813680	
Q	153	Pjeter	Hile	Skandaj	2/6	1320	900	1188000	21120					1209120	
E	154	Gac	Mark	Skandaj	2/5	1298	900	1168200	20768					1188968	
L	155	Jak	Mark	Skandaj	2/4	1980	900	1782000	31680					1813680	
	156	Rrok	Mark	Skandaj	2/3	1848	900	1663200	29568					1692768	
	157	Sander	Mark	Skandaj	2/2	924	900	831600	14784					846384	
	158	Mark	Dode	Skandaj	2/1	924	900	831600	14784					846384	
	159	Age	Ded	Suli	79/8	1914	900	1722600	30624					1753224	
1	160	Cesk	Kol	Suli	79/7	660	900	594000	10560					604560	
7	161	Kol	Nikoll	Suli	79/6	3322	900	2989800	53152					3042952	
1	162	Bardhok	Zef	Suli	79/5	704	900	633600	11264					644864	
6	163	Nikoll	Zef	Suli	79/4	726	900	653400	11616					665016	
	164	Zef	Nikoll	Suli	79/3	1584	900	1425600	25344					1450944	
G	165	Ndue	Pjeter	Zhuba	79/18	1386	900	1247400	22176					1269576	
J	166	Lazer	Pjeter	Zhuba	79/17	1323	900	1190700	21168					1211868	
A	167	Zef	Rrok	Zhuba	79/16	952	900	856800	15232					872032	
D	168	Tom	Shtjefen	Zhuba	79/15	952	900	856800	15232					872032	
E	169	Gjon	Shtjefen	Zhuba	79/14	952	900	856800	15232					872032	

R	170	Zef	Llesh	Lukani	79/2	2310	900	2079000	36960					2115960	
	171	Pal	Rrok	Figuri	79/1	2420	900	2178000	38720					2216720	
1	172	Prek	Jak	Geci	506/12	1144	900	1029600	18304					1047904	
	173	Gjovalin	Jak	Geci	506/11	1496	900	1346400	23936					1370336	
4	174	Hil	Vlash	Gjoka	506/10	2478	900	2230200	39648					2269848	
	175	Lazer	Vlash	Gjoka	506/9	420	900	378000	6720					384720	
4	176	Ndue	Pjeter	Gjoka	506/8	779	900	701100	12464					713564	
	177	Dile	Pjeter	Gjoka	506/7	63	900	56700	1008					57708	
3	178	Ndoc	Liq	Miloti	506/6	504	900	453600	8064					461664	
	179	Gjin	Ndoc	Miloti	506/5	735	900	661500	11760					673260	
4	180	Lazer	Ndoc	Miloti	506/4	1386	900	1247400	22176					1269576	
	181	Zek	Ndoc	Miloti	506/3	441	900	396900	7056					403956	
	182	Ejell	Ndoc	Miloti	506/2	902	900	811800	14432					826232	
	183	Ejell	Lek	Miloti	506/1	874	900	786600	13984					800584	
	184	Marte	Mark	Doci	494/13	110	900	99000	1760					100760	
	185	Mark	Ded	Jaku	494/12	528	900	475200	8448					483648	
	186	Marte	Mark	Doci	494/18	880	900	792000	14080					806080	
	187	Pal	Pjeter	Frroku	494/17	1254	900	1128600	20064					1148664	
	188	Geg	Llesh	Gazulli	494/11	1210	900	1089000	19360					1108360	
	189	Llesh	Geg	Gazulli	494/14	220	900	198000	3520					201520	Pretendim pronesie
	190	Vlash	Geg	Gazulli	494/20	286	900	257400	4576					261976	
	191	Gjergj	Gjin	Doci	494/16	396	900	356400	6336					362736	
	192	Dod	Pal	Miloti	494/10	418	900	376200	6688					382888	
	193	Skender	Qamil	Fetahi	494/9	814	900	732600	13024					745624	
	194	Hil	Lazer	Gazulli	494/24	525	900	472500	8400					480900	
	195	Daniel	Shuk	Gazulli	494/23	465	900	418500	7440					425940	

	196	Ndue	Pjeter	Gjoka	494/7	880	900	792000	14080					806080	
	197	(Ndue Kola)	(Gege Gjoka)		494/6	352	900	316800	5632					322432	Pretendim pronesie
	198	Mark	Ded	Jaku	494/15	704	900	633600	11264					644864	
	199	Pep	Simon	Miloti	494/5	66	900	59400	1056					60456	
	200	Kol	Shtjefen	Gjoka	494/4	418	900	376200	6688					382888	
	201	Pep	Simon	Miloti	494/3	374	900	336600	5984					342584	Konfirmim nga Z.R.P.P
	202	Gac	Shuk	Shtjefni	494/22	880	900	792000	14080					806080	
	203	Gjergj	Pjeter	Meli	494/1	572	900	514800	9152					523952	
	204	Geg	Gac	Miloti	446/9	4024	900	3621600	64384					3685984	
	205	Bardhok	Ndrek	Gazulli	445/8	3700	900	3330000	59200					3389200	
	206	Bardhok	Mark	Cumraku	445/11	202	900	181800	3232					185032	
	207	Mark	Ded	Gazulli	444/11	4070	900	3663000	65120					3728120	
	208	Ndrek	Pjeter	Gazulli	443/10	4070	900	3663000	65120					3728120	
	209	Ded	Jak	Gjergji	364/8	2765	900	2488500	44240					2532740	
	210	Bib	Jak	Gjergji	364/6	1520	900	1368000	24320					1392320	
	211	Cef	Lin	Gazulli	356/9	4375	900	3937500	70000					4007500	
	212	Zef	Lin	Gazulli	356/11	237	900	213300	3792					217092	
	213	Simon	Lorenc	Prendi	278/10	2400	900	2160000	38400					2198400	
	214	Nikoll	Ndoc	Ndreca	278/9	294	900	264600	4704					269304	
	215	Zef	Ndoc	Ndreca	278/16	483	900	434700	7728					442428	
	216	Ndoc	Ndrek	Ndreca	278/8	735	900	661500	11760					673260	
D	217	Mark	Rrok	Lumshi	278/4	1474	900	1326600	23584					1350184	
	218	Rrok	Mark	Lumshi	278/3	484	900	435600	7744	30000				473344	
A	219	Aleksander	Rrok	Lumshi	278/2	550	900	495000	8800		72/30	24688/3141	1871766	2375566	
	220	Shtjefen	Preng	Bushi	278/1	1056	900	950400	16896					967296	

J	221	Ndue	Nikoll	Gjini	277/4	2640	900	2376000	42240					2418240	
	222	Shuk	Shtjefen	Shtjefni	277/3	480	900	432000	7680					439680	
	223	Ndoc	Mark	Shtjefni	277/1	4752	900	4276800	76032					4352832	
C	224	I paidentifikuar			165	1458	900	1312200	23328					1335528	Pretendim pronesie
	225	Gac	Mark	Marku	164/5	612	900	550800	9792					560592	
	226	Mark	Ejll	Marku	164/6	1588	900	1429200	25408					1454608	
	227	Prek	Shtjefen	Paloci	164/4	1290	900	1161000	20640					1181640	
	228	Rrok	Dod	Paloci	164/8	665	900	598500	10640					609140	
	229	Geg	Shtjefen	Paloci	164/9	115	900	103500	1840					105340	
	230	Rrok	Dod	Paloci	164/10	60	900	54000	960					54960	
	231	I paidentifikuar			164/17	155	900	139500	2480					141980	Pretendim pronesie
	232	I paidentifikuar			164/16	133	900	119700	2128					121828	Pretendim pronesie
	233	I paidentifikuar			163	1211	900	1089900	19376					1109276	Pretendim pronesie
	234	Gac	Shuk	Shtjefni	163/8	2778	900	2500200	44448					2544648	
	235	Gjin	Shuk	Shtjefni	163/7	300	900	270000	4800					274800	
	236	Nikoll	Ndue	Lleshi	162/5	1931	900	1737900	30896					1768796	
	237	Gjin	Shuk	Shtjefni	162/6	1515	900	1363500	24240					1387740	
	238	Dod	Shuk	Shtjefni	162/7	321	900	288900	5136					294036	
SHUMA						240420		216378000	3827520	543000			1871766	222620286	

Shenim : Mbyllet me numer rendor 238 (dyqindetridhjetete)

Shenim : Per te gjithë personat me shenimet “Proces regjistrimi”, “Konfirmim nga Z.RPP” dhe “Pretendim pronesie” t’u mbahet e bllokuar pagesa deri ne nje njoftim te dyte nga ana jone, deri sa te sjellin dokumentet e pronësise.

V E N D I M
Nr.315, datë 24.4.2003

**PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE DHE TË
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Përkufizimi i pasurisë publike, elementet e konkurrencës, e drejta, kompetencat dhe afatet e dhënies me qira

1. Pasuritë e ndërmarrjeve, të shoqërive dhe të institucioneve shtetërore, ku përfshihen ndërtesat, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), si dhe makineritë e pajisjet, u jepen me qira të tretëve, nëpërmjet procedurës së konkurrencës publik.

2. Elementet e konkurrencës për dhënie me qira të jenë:

a) Për veprimtaritë prodhuese:

- niveli i investimit;

- punësimi;

- çmimi i qirasë mujore.

b) Për shërbime: zyra, magazina, shërbime tregtare etj.;

- çmimi i qirasë mujore për m2.

Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin kritere të veçanta për mjediset që jepen me qira, për bar-kafe, në ndërtesat e tyre.

3. Për objektet me karakter kombëtar: muzeal, historik e arkeologjik, përveç elementeve të konkurrencës, të përfshira në pikën 1.2, ministria përkatëse dhe institucionet qendrore, që ushtrojnë të drejtën e administrimit të pronës shtetërore për këto objekte, të vendosin edhe kushte e kritere të veçanta për ruajtjen e vlerave kombëtare të objektit.

4. Përjashtohen nga konkurrenca:

a) Sipërfaqet deri në 200 m², të cilat jepen me qira, me afat deri në 1 vit.

b) Objektet, në shërbim të shfrytëzimit të pasurive natyrore, të cilat u jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë, subjekteve të pajisura me leje shfrytëzimi minerar, peshkimi dhe të ujërave.

5. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe afatet e dhënies me qira të jenë si më poshtë vijon:

a) Organi drejtues i ndërmarrjes, shoqërisë ose institucionit shtetëror jep me qira, për një afat jo më shumë se 1 vit kalendarik, objekte me sipërfaqe deri në 200 m². Dhënia me qira mbi këtë afat bëhet me miratimin e organit, që ushtron të drejtën e varësisë administrative mbi ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror.

b) Organi, që ushtron të drejtën e varësisë administrative mbi ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionet shtetërore jep me qira, për një afat jo më shumë se 5 vjet, objektet me sipërfaqe 201 deri në 500 m². Dhënia me qira mbi këtë afat bëhet me miratimin e organit që ka të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore për ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror.

c) Organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet për ndërmarrjen, shoqërinë a institucionin shtetëror, jep me qira, për një afat deri në 20 vjet, objektet me sipërfaqe mbi 501 m², si dhe një grup depozitash të ndryshme lëngu, gazi, drithi, karburantesh etj.

Dhënia me qira e pronave të pushtetit vendor, për pasuritë deri në 200 m² bëhet me miratimin e drejtuesit të institucionit të varësisë administrative të ndërmarrjes, shoqërisë ose institucionit shtetëror, ndërsa mbi 200 m² nga organi përkatës i pushtetit vendor dhe ato të pushtetit vendor, për sipërfaqe mbi 500 m² me vendim të këshillit bashkiak, në përputhje me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

II. Procedurat e dhënies me qira të pasurisë publike

1. Procedurat e publikimit fillojnë me urdhër të drejtuesit të organit, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës, i cili duhet të përmbajë:

- a) të dhënat e njoftimit për publikim të objektit që jepet me qira;
- b) pikët vlerësuese për elementet e konkurrit, të përcaktuara në pikën 1.2 të këtij vendimi;
- c) përbërjen dhe emërimin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit të konkurrit;
- ç) qëllimin e dhënies me qira;
- d) kohën e publikimit;
- d) datën, orën dhe vendin e mbledhjes së komisionit.

2. Publikimi i konkurrit për objektet që jepen me qira, bëhet nga organi që ka të drejtën e lidhjes së kontratës, sipas pikës 1.5 të këtij vendimi ose nga organi i varësisë administrative, dy herë brenda një jave, në një organ të shtypit periodik.

3. Ndërmarrja, shoqëria ose institucioni shtetëror, i cili ka në administrim objektin që jepet me qira, përgatit dokumentacionin për dhënien me qira, i cili përmban:

a) genplanin e objektit, ku të jetë shënuar sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë), i vërtetuar nga urbanistika e organit të qeverisjes vendore dhe nga organi drejtues, që ka të drejtën e përfaqësimit të personit juridik për ndërmarrjen, shoqërinë e institucionin shtetëror;

b) listën e makinerive, të pajisjeve, linjave teknologjike, galerive minerare etj., që do të jepen me qira, vlerat kontabël të tyre dhe vitin e blerjes ose, kur mungojnë këto të dhëna, vlera të jetë e miratuar nga eksperti vlerësues;

c) aktin e vlerësimit të truallit, të lëshuar nga organi i qeverisjes vendore ku ndodhet objekti, që jepet me qira;

ç) certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive;

d) çmimet dysheme të qirasë.

4. Njoftimi për publikim duhet të përmbajë të dhënat përkatëse për:

- a) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit që jepet me qira;
- b) vlerën dysheme të qirasë, për konkurrim;
- c) sipërfaqen e objektit (ndërtesë dhe truall);
- ç) qëllimin e dhënies me qira;
- d) afatin e dhënies me qira të objektit;
- dh) datën, orën dhe vendin e dorëzimit të kërkesave;
- e) dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet private për konkurrim;
- ë) datën, orën dhe vendin e mbledhjes së komisionit.

5. Dokumentacioni i subjekteve të interesuara për marrjen me qira të pronës publike dorëzohet në organin që ka bërë publikimin brenda 30 ditëve, pas datës së parë të publikimit dhe duhet të përmbajë:

- kërkesën e subjektit për marrjen me qira;
- planbiznesin për rivënien në funksionim të objektit;
- planin e investimit dhe të punësimit;
- çmimin e qirasë mujore të ofruar, në zarf të mbyllur nga konkurruesi;
- dokumentacionin ligjor (vendim gjykate, statusi, akti i themelimit) të subjektit që kërkon marrjen me qira;

- dokumentacionin fiskal të subjektit që kërkon marrjen me qira (NIPT, certifikatë tatimore);

- vërtetimin nga prokuroria dhe gjykata, se subjekti nuk ka çështje penale ose civile, që kanë lidhje me biznesin që ushtron;

- vërtetim nga dega e tatimeve që subjekti ka shlyer rregullisht detyrimet tatimore.

6. Shqyrtimi i dokumentacionit për dhënien me qira të bëhet në prani të konkurrentëve nga një komision i ngritur me urdhër të drejtuesit të organit, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës, brenda 20 ditëve nga data e mbylljes së dorëzimit të kërkesave. Kur paraqitet një kërkesë e vetme, publikimi përsëritet vetëm një herë. Komisioni, pasi shqyrton dokumentacionin, në prani të konkurrentëve, shpall fituesin dhe ia propozon për miratim drejtuesit të organit, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës.

7. Monitorimi i kontratave të qirasë bëhet nga qiradhënësi. Kontratat e qirasë dhe të enfiteozës, të lidhura para daljes së këtij vendimi, të monitorohen në bazë të kushteve të parashikuara në kontratat e lidhura.

III. Përcaktimi i çmimit dysheme

Çmimi dysheme i qirasë mujore caktohet si shumë e çmimeve të ndërtesës, truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë), linjave teknologjike, makineri-pajisjeve, galerive etj., të përcaktuara sipas pikave vijuese të këtij vendimi.

1. Për sipërfaqe ndërtesë. Ndërtesat quhen të tilla, sipas përcaktimeve të pikës 115 të rregullores së urbanistikës, të miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

a) Për ndërtesat:

- brenda unazës së vjetër të bashkisë së Tiranës, jo më pak se 300 lekë/m² në muaj, ndërtesa jashtë unazës, por, brenda vijave kufizuese të bashkisë së Tiranës, jo më pak se 200 lekë/m² në muaj;

- brenda vijave kufizuese të bashkive: Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Laç, Lezhë, jo më pak se 150 lekë/m² në muaj;

- jashtë vijave kufizuese të bashkive të përmendura më lart, jo më pak se 100 lekë/m² në muaj;

- brenda vijave kufizuese të bashkive: Devoll, Kolonjë, Mallakastër, Peqin, Tepelenë, Dibër, Pukë, Kukës, Përmet, Delvinë, Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Skrapar, Tropojë, Ura Vajguore, Manëz, Sukth, Shijak, Fushë-Krujë, Cërrik, Patos, Roskovec, Divjakë, Libohovë, Maliq, Shëngjin, Vau i Dejës, Kamëz, Vorë, Rrogozhinë, Himarë, Selenicë, Orikum, Konispol, si dhe bashkive të tjera, që do të shpallen të tilla me akte ligjore, jo më pak se 100 lekë/m² në muaj;

- jashtë vijave kufizuese të bashkive të përmendura më lart, jo më pak se 50 lekë/m² në muaj.

b) Për zyra, dyqane “Duty Free” dhe agjenci shërbimi në aeroporte, porte, dogana jo më pak se 2 500 lekë/m² në muaj.

c) Për ndërtesat e institucioneve me karakter kombëtar: muzeale, historike, arkeologjike e të kulturës:

- në bashkinë e Tiranës, jo më pak se 600 lekë/m² në muaj;

- në zonat e tjera, jo më pak se 300 lekë/m² në muaj.

2. Për makineritë, pajisjet, linjat teknologjike e galeritë minerare qiraja vjetore llogaritet sipas VAM-it të llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi, pjesëtuar me vitet e mbetura deri në amortizimin e plotë të tyre. Në rastin kur makineritë, pajisjet, linjat teknologjike e galeritë minerare janë të amortizuara, llogaritja e qirasë vjetore të bëhet sipas VAM-it, të përcaktuar nga eksporti vlerësues dhe të miratuar nga komisioni vlerësues i ndërmarrjes, pjesëtuar me 10.

3. Për rezervuarët, depozitat e karburantit dhe silloset, që jepen me qira me qëllim tregtimi, brenda vijave kufizuese të qyteteve: Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Laç, Lezhë, çmimi dysheme i qirasë është jo më pak se 400 lekë/m³ në muaj, ndërsa jashtë vijave kufizuese të këtyre qyteteve, si dhe në të gjitha zonat e tjera, çmimi i qirasë është jo më pak se 200 lekë/m³ në muaj.

4. Për truallin e lirë funksional (jo nën ndërtesë), çmimi dysheme i qirasë vjetore është 1/10 e çmimit të shitjes së truallit, i përcaktuar sipas vendimit nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare”.

5. Për terrenet sportive, çmimi dysheme i qirasë mujore është jo më pak se 50 lekë/m² në muaj.

IV. Nxitja e biznesit

1. Vlera e qirasë vjetore të rillogaritur me zbritje të shumës së dy kriterëve, kur subjekti qiramarrës plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Për punësimin mesatar vjetor, të vërtetuar me dokument nga sigurimet shoqërore:

- kur punësohen 5-10 veta, zbritja është 5 për qind;
- kur punësohen 11-20 veta, zbritja është 10 për qind;
- kur punësohen 21-50 veta, zbritja është 20 për qind;
- kur punësohen 51-150 veta, zbritja është 30 për qind;
- kur punësohen 151-300 veta, zbritja është 40 për qind;
- kur punësohen 301-500 veta, zbritja është 45 për qind;
- kur punësohen mbi 501 veta, zbritja është 50 për qind;

b) Për investimet e kryera:

- 200 mijë deri në 300 mijë USD, zbritja është 5 për qind;
- 301 mijë deri në 500 mijë USD, zbritja është 10 për qind;
- 501 mijë deri në 1 milion USD, zbritja është 20 për qind;
- mbi 1 milion USD, zbritja është 30 për qind.

2. Për zonat verilindore, të cilat janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, kriteret lehtësuese, sipas pikës IV.1, zbatohen duke u shumëzuar me koeficientin 1.5.

V. Shpërndarja e të ardhurave

1. Të ardhurat që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë, të ndahen si më poshtë vijon:

a) Për objektet deri në 200 m²:

- 50 për qind Buxheti i Shtetit;
- 50 për qind ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

b) Për objektet 201-500 m²:

- 50 për qind Buxheti i Shtetit;
- 10 për qind organi, që ushtron të drejtën e varësisë administrative mbi ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror;
- 40 për qind ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

c) Për objektet mbi 500 m²:

- 40 për qind Buxheti i Shtetit;
- 10 për qind organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore: Ministria e Ekonomisë;
- 10 për qind organi, që ushtron të drejtën e varësisë administrative mbi ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror;
- 40 për qind ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

2. Të ardhurat që krijohen nga dhënia me qira e objekteve të institucioneve, ndërmarrjeve a shoqërive shtetërore, me karakter kombëtar historik e kulturor, të ndahen si më poshtë vijon:

- 10 për qind Buxheti i Shtetit;
- 10 për qind organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore: Ministria e Ekonomisë ose organi i pushtetit vendor;
- 20 për qind organi, që ushtron të drejtën e varësisë administrative mbi ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror;
- 60 për qind institucioni, ndërmarrja a shoqëria shtetërore.

3. Të ardhurat që krijohen nga dhënia me qira e pasurive të institucioneve, ndërmarrjeve a shoqërive shtetërore të pushtetit vendor, të ndahen si vijon:

- 10 për qind e Buxhetit të Shtetit;
- 60 për qind e ndërmarrjes, shoqërisë ose institucionit;
- 30 për qind organit të varësisë, domethënë bashkisë ose komunës.

VI. Përdorimi i të ardhurave

1. Të ardhurat që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë, të përdoren nga ndërmarrjet, shoqëritë ose institucionet shtetërore, si më poshtë vijon:

- për të mbuluar detyrimet ndaj të tretëve dhe për tatim-taksa;
- për shpenzimet, për paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të ndërmarrjes;
- për të mbuluar shpenzimet, për riparime kapitale dhe investime.

2. Të ardhurat nga qiratë për ministritë ose të institucioneve të tjera buxhetore, të përdoren sipas vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

VII. Kontratat e qiradhënies, të lidhura sipas këtij vendimi, janë të vlefshme deri në çastin kur prona publike e dhënë me qira kalon për privatizim.

VIII. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore e vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.316, datë 24.4.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 21.1.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN E PRONËSISË SHTETËRORE NË DISA SHOQËRI
TREGTARE DHE NDËRMARRJE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në listën e pikës 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.78, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, emërtesat e listës nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në të cilat ruhet pronësia shtetërore, shfuqizohen.
 2. Pronësia shtetërore ruhet për ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe ministritë e linjës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista nr.1

LISTA E NDËRMARRJEVE DHE SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILËN RUHET PRONËSIA
SHTETËRORE

N r	Emërtimi	Vendndodhja	Vartësia	Statusi	% e pjesëmarrjes në kapitalin shtetëror
1	Regjistri detar shqiptar	Durrës	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	Shoqëri anonime	100
2	Ndërmarrja e objekteve sportive	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Shoqëri Anonime	100
3	Qendra e realizimit të veprave të artit	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Ndërmarrje shtetërore	100
4	Qendra Ndërkombëtare e Kulturës	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Ndërmarrje shtetërore	100
5	Alba Film Animacion	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Në transformim	100
6	Alba Film Studio	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Në transformim	100
7	Uzina e armatimit	Gramsh	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
8	Uzina e riparimit të avionëve	Kucovë	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
9	Uzina e lëndëve plasëse	Elbasan	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje	100

	Mjekës			shtetërore	
10	Riparim artileri	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
11	Kombinati i armatimit	Polican	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
12	Riparim tanku	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Shoqëri snonime	100
13	Ndërmarrje e prodhimit të veshjeve të ushtrisë	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
14	Autoreparti	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Shoqëri anonime	100
15	Elektronikë e ushtrisë	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Shoqëri anonime	100
16	Shtëpia e pushimit të ushtarakëve	Pogradec	Ministria e Mbrojtjes	Shoqëri anonime	100
17	Tipografia ushtarake	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Shoqëri anonime	100
18	Shtëpia Qendrore e Ushtrisë	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Në transformim	100
19	Shtëpia e pushimit të ushtarakëve	Durrës	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
20	Shtëpia e pushimit e Ministrisë së Rendit	Durrës	Ministria e Rendit Publik	Ndërmarrje shtetërore	100

Lidhja nr.2

Nr	Emërtimi	Vendndodhja	Varësia	Statusi	%e pjesës së shtetit në kapital
1	Ndërmarrja e botimit të librit shkollor	Tiranë	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Shoqëri anonime	100
2	Ndërmarrja e shpërndarjes së librit shkollor	Tiranë	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Shoqëri anonime	100
3	Albkontroll	Durrës	Ministria e Ekonomisë	Shoqëri anonime	100
4	Buka	Tiranë	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	Shoqëri anonime	51
5	Coca - Cola	Tiranë	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	Shoqëri e përbashkët	2.65
6	Drejtoria e farnave Degët në rrethe	Tiranë Kukës, Fier, Dibër, Korçë, Berat, Tiranë	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	Ndërmarrje shtetërore	100
7	Kripa	Vlorë	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës	Shoqëri anonime	100
8	Kombinati Energjetik	Elbasan	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës	Shoqëri anonime	100

9	Qendra e informatizimit financiar	Tiranë	Ministria e Financës	Shoqëri anonime	100
10	Qendra e regjistrimit të aksioneve	Tiranë	Ministria e Financës	Shoqëri anonime	100
11	Disko Bar Lux	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Shoqëri e përbashkët	20
12	Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Shoqëri e përbashkët	45
13	Qendra e llotarive sportive	Tiranë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Shoqëri anonime	100
14	Ndërmarrja e prodhim material ndërtimi të ushtrisë	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes	Ndërmarrje shtetërore	100
15	Agjencia Detare Taulantia	Durrës	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	Shoqëri anonime	100
16	Anijet e shërbimit detar	Durrës	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	Shoqëri anonime	100
17	Ndërmarrja e shfrytëzimit të mjeteve ujore Vau i Dejës	Shkodër	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	Ndërmarrje shtetërore	100
18	Trans Albania	Tiranë	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	Shoqëri e përbashkët	49
19	Ndërmarrja e shërbimeve të transportit	Tiranë	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	Ndërmarrje shtetërore	100
20	Inetkinex	Tiranë	Bashkia	Shoqëri e përbashkët	49
21	Fufarma	Tiranë	Ministria e Shëndetësisë	Shoqëri anonime	70

V E N D I M
Nr.319, datë 15.5.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.13, DATË 13.1.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E SHKOLLËS PASUNIVERSITARE NË ADMINISTRIM BIZNESI” DHE NË VENDIMIN NR.588, DATË 2.11.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE, PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, UNIVERSITETIT POLITEKNIK, UNIVERSITETIT BUJQËSOR DHE AKADEMISË SË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 37 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2 e vendimit nr.13, datë 13.1.2000 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Tarifa e shkollimit për SHPU-të në “Administrim Biznesi” të jetë:

- Për kandidatët nga stafi akademik, efektiv i shkollave të larta publike 75 000 lekë;
 - Për kandidatët e tjerë nga sistemi buxhetor 100 000 lekë;
 - Për kandidatët jobuxhetorë 150 000 lekë”
2. Pika 4 e vendimit nr.588, datë 2.11.2000 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:
- “4.Tarifat e shkollimit për SHPU-të e mësipërme të jenë:
- a) Për SHPU-të në “Studime europiane”:
- për kandidatët nga stafi akademik, efektiv i shkollave të larta publike 75 000 lekë;
 - për kandidatët e tjerë nga sistemi buxhetor 100 000 lekë;
 - për kandidatët jobuxhetorë 150 000 lekë”
- b) Për SHPU-të pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës:
- për kandidatët nga stafi akademik, efektiv i shkollave të larta publike 55 000 lekë;
 - për kandidatët e tjerë nga sistemi buxhetor 120 000 lekë;
 - për kandidatët jobuxhetorë 160 000 lekë”
- c) Për SHPU-të e tjera, pranë Fakulteteve të Drejtësisë, të Ekonomikut, të Gjuhëve të Huaja, të Historisë e të Filologjisë dhe të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës:
- për kandidatët nga stafi akademik, efektiv i shkollave të larta publike 50 000 lekë;
 - për kandidatët e tjerë nga sistemi buxhetor 100 000 lekë;
 - për kandidatët jobuxhetorë 150 000 lekë”
3. SHPU-të administrojnë të ardhurat që mbledhin, sipas akteve ligjore e nënligjore, në fuqi, për mbulimin e shpenzimeve të tyre.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

U D H Ë Z I M

Nr.1, datë 9.5.2003

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.159, DATË 13.3.2003 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURA E SHITJES”

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes”, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit nxjerrin këtë

U D H Ë Z I M:

1. Të gjitha miratimet e privatizimit, para hyrjes në fuqi të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”, si dhe ngritja e komisioneve të vlerësimit dhe miratimi i ekspertëve në zbatim të tyre, do të konsiderohen të vlefshme, por përgatitja e dokumentacionit të vlerësimit dhe procedurat e shitjes do të bëhen në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003.
2. Te kapitulli i I-rë pika 4 për vlerësimin e mjeteve të transportit tokësor dhe detar, të blera ose të vëna në shfrytëzim pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), shprehja “... pa zbatuar indeksin e çmimit ...” të kuptohet “... raportin e indeksit ...”.
3. Në kapitullin e I-rë pika 12 për vlerësimin e objekteve, makinerive dhe pajisjeve etj. të

shoqërive tregtare, si vlerë fillestare sipas kontabilitetit do të konsiderohet vlera e përcaktuar në dokumentacionin e transformimit në shoqëri anonime e regjistruar në gjykatë (në regjistrin tregtar).

4. Për rastet kur në ankandin për shitjen e objekteve ose aseteve me vlerë fillestare, me VAM të ulur me rezervë dhe me zarfa të mbyllur paraqitet vetëm një kërkesë përpara komisionit të ankandit; komisioni duhet ta evidentojë këtë kërkesë në procesverbalin e ankandit dhe objekti t'i nënshtrohet procedurës së ripublikimit sipas pikës 9 kapitulli i III-të i këtij vendimi.

5. Për zbatim të pikës 2 paragrafi i I-rë për rastet e shitjes së objekteve me pronar truall, me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit pranë AKP-së Tiranë, kjo e fundit afishon njoftimin në ambientet e ndërmarrjes që e administron atë. Ish-pronari i truallit që dëshiron të blejë objektin duhet të paraqitet pranë AKP-së Tiranë, brenda një afati 20 ditor nga dita e publikimit (afishimit), duke depozituar kërkesën me shkrim në të cilën shprehet se dëshiron të blejë objektin në fjalë, dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20 për qind të vlerës së pronës që kërkon të blejë dhe vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, të noterizuar, i cili përcakton se ai është pronar i tokës.

6. Në rast se brenda këtij afati kohor ish-pronari nuk paraqitet, AKP-ja nxjerr objektin në publikim. Në qoftë se ditën e zhvillimit të ankandit paraqitet edhe pronari i truallit, me dokumentet përkatëse të pronësisë, komisioni i ankandit, pas vlerësimit të dokumentacionit në fjalë shpall fitues ankandin pronarin e truallit, pa konkurrim. Për rastet kur komisioni i ankandit ka vështirësi në vlerësimin e dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga pronari i truallit, atëherë komisioni i ankandit cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, me qëllim që të vlerësojë dokumentacionin e pronësisë.

7. Në zbatim të pikës 3 kapitulli i III-të me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit për shitjen e makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës, degët e AKP-ve në prefektura njoftojnë me shkrim AKP-në në qendër, nga e cila marrin konformimin për fillimin e procedurave të shitjes. Pas marrjes së konfirmimit degët e AKP-ve afishojnë njoftimin në ambientet e saj dhe të ndërmarrjes që i ka në administrim ato. Punonjësit që i kanë ose i kanë pasur në përdorim makineritë, automjetet, pajisjet ose mjetet e punës dhe dëshirojnë t'i blejnë, duhet të paraqesin pranë degës së AKP-së brenda afatit 20 ditor të afishimit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20 për qind të vlerës së pronës që kërkojnë të blejnë. Dosja e privatizimit duhet të përmbajë edhe vërtetimin për punonjësit që i kanë ose i kanë pasur në përdorim këto asete.

8. Në rast se punonjësit që i kanë pasur ose i kanë në përdorim mjetet nuk paraqesin kërkesë për blerjen e tyre brenda afatit të përcaktuar më lart, ato kalojnë në publikim sipas procedurave të vendimi të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003. Në këtë rast dega e AKP-së njofton dhe organet e rendit në prefekturë për automjetet ose mjetet e transportit që janë në procedurë privatizimi për t'i bllokuar ato deri në përfundimin e privatizimit të tyre. Me lidhjen e kontratës së shitblerjes, dega e AKP-së njofton organet përkatëse të rendit për transferimin e lejes së qarkullimit të automjetit tek pronari i ri, konform akteve normative në fuqi.

9. Në zbatim të pikës 4 kapitulli i III-të, punonjësit specialistë, farmacistë ose stomatologë, që kanë aktualisht kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes, sipas çmimit të përcaktuar në ankand, vetëm në rastet kur për këto objekte nuk ka pronarë truall. Në rastin kur pronarët e truallit të objektit kanë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë dhe kërkesën për blerjen e objektit sipas pikës 8-të të këtij kapitulli, por nuk paraqiten në ankandin e objektit që ndodhet në pronën e tyre, komisioni i ankandit evidenton kërkesat për blerje në procesverbalin përkatës dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda pesë ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, duke njoftuar edhe një herë pronarët e truallit. Nëse edhe në këtë datë pronarët e truallit nuk paraqiten për blerjen e objektit, atëherë AKP-ja realizon shitjen me ankand të këtij objekti.

10. Në zbatim të pikës 5 kapitulli i III-të AKP-ja me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, mund të përdorë edhe forma të tjera publikimi në media televizive, postera etj. Shpenzimet e publikimit do të përballohen nga të ardhurat e privatizimit.

11. Shkresa përcjellëse e degës së shoqërive publike, e organeve të varësisë, që shoqëron dokumentacionin përkatës të vlerësimit duhet të përmbajë të specifikuar qartë: emërtimin e objektit, vendndodhjen e tij, sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nënobjekt, vlerën gjithsej të objektit, e ndarë në vlerën e mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros, si dhe përmbajtjen e dokumentacionit të vlerësimit etj.; në të kundërt dokumentacioni i vlerësimit konsiderohet i parregullt.

12. Në pasqyrat e vlerësimit duhet të shënohet qartë në kolonën përkatëse indeksi i çmimit të

përdorur, si dhe koeficienti i vendndodhjes së objektit.

13. Në zbatim të pikës 7 kapitulli i III-të, pjesëmarrësit në ankand në vendin, datën dhe orën e njoftuar duhet të paraqesin pranë komisionit të ankandit edhe dokumentin e identifikimit të tyre (letërnjoftimin, certifikatë me fotografi). Disa persona kanë të drejtën e paraqitjes për blerje të objektit së bashku me një kërkesë të vetme. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me dokumentin bankar që përmban emrat e personave që bashkohen në këtë blerje. Në rast të paraqitjes së një blerësi, personat e tjerë kërkuar duhet të përfaqësohen me prokurë.

14. Në zbatim të pikës 10 paragrafi i II-të kapitulli i III-të, pas shpalljes së fituesit të ankandit për shitjen me rezervë, AKP-ja nënshkruan me fituesin e ankandit aktmarrëveshjen në të cilën pasqyrohen afati i likuidimit të objektit, vlera e kësteve që do të shlyhen dhe afatet e likuidimit të tyre, dorëzimi i objektit etj. Kjo aktmarrëveshje do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes që do të lidhet për objektin.

15. Pjesëmarrësit në ankand për blerjen e objektit me zarfa të mbyllur, nuk mund të paraqesin më shumë se një ofertë në zarfin përkatës.

16. Në zbatim të pikës 14 kapitulli i III-të, juristi i AKP-së (që merr pjesë në ankand pa të drejtë vote) ka të drejtë të kërkojë me shkrim ndërprerjen ose pezullimin e ankandit, në rast se konstaton shkelje të rregullores së ankandit, si dhe të procedurave për zhvillimin e tij. Pretendimi i tij i nënshtrohet gjykimit dhe votimit të shumicës. Vendimmarrja për pezullimin ose jo të ankandit i paraqitet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së. Në rast miratim pezullimi, vazhdimi i procedurave të zhvillimit të ankandit do të bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së, jo më shumë se tri ditë.

17. Në zbatim të pikës 18 kapitulli i III-të personi që ka fituar të drejtën e blerjes për objektin dhe nuk paguan vlerën e plotë të tij brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij si fitues ankandi ose pronar truallit, humbet vlerën prej 20 për qind të paguar për pjesëmarrje në ankand, si dhe të drejtën për të marrë pjesë përsëri në ankandin që do të zhvillohet për rishitjen e objektit në fjalë.

18. Në zbatim të pikës 5, germa (a) kapitulli IV-t për rastet e privatizimit tërësor të ndërmarrjeve, të linjave të shërbimit dhe të prodhimit, të objekteve së bashku me makineritë, të pajisjeve, të mjeteve të xhiros etj. që janë pjesë përbërëse të objektit; objektet ndërtimore të veçanta, pasi të kenë kaluar të gjitha procedurat, do të kontrollohen nga Ministria e Ekonomisë dhe do të dërgohen në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

19. Makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, mjetet e xhiros, që privatizohen të veçuara, pasi të kontrollohen nga dega e shoqërisë publike, do të përcillen direkt në degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në prefekturën përkatëse.

20. Në zbatim të pikës 7 kapitulli IV, verifikimi i pronës që do të privatizohet bëhet nga përfaqësuesi i degës së shoqërive publike, drejtori ose likuidatori dhe përfaqësuesi i AKP-së menjëherë pas daljes së miratimit të privatizimit. Vlerësimet e bëra pasqyrohen në aktverifikim, i cili do të jetë pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit. AKP-ja pasi pranon dokumentet e vlerësimit të objektit duhet të bëjë marrjen në dorëzim të tij brenda 15 ditëve para se të fillojë publikimi për shitje.

21. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes” dhe këtij udhëzimi për zbatimin e këtij vendimi ka të drejtë të hartojë dhe të miratojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatëse në përputhje të legjislacionit në fuqi, për të rritur efikasitetin e privatizimit.

22. AKP-ja kthen për riindeksim në degët e shoqërive publike të gjitha dosjet e objekteve të privatizuara, për të cilat me vendim gjykatë të formës së prerë është prishur kontrata e shitjes duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Dega e shoqërive publike, pasi bën riindeksimin e vlerës së këtyre dosjeve i dërgon ato në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit Tiranë, e cila fillon procedurat e privatizimit të objektit, sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 dhe udhëzimit në zbatim të tij.

23. Publikimi në gazetën me qarkullim kombëtar për objektin që do të privatizohet, përveç informacionit plotësues të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, përmban edhe tabelën me të dhënat sipas formatit si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillest.e	Mjete xhiroje	Sipërfaqe gjithsej e	Sipërfaqe nën	Vlera e truallit
-----	---------------------	-------------	-----------------	---------------	----------------------	---------------	------------------

			ankandit (në lekë)	(në lekë)	objektit (në m2)	objekt (në m2)	në (lekë)
1							
2							
...							

24. Dokumentacionet e vlerësimit të objekteve, makinerive, pajisjeve etj. të cilat kanë mbaruar procedurën e privatizimit dhe rezultojnë të pashitura të kthehen në degët e shoqërive publike përkatëse dhe këto të fundit t'i kthejnë në ndërmarrje apo institucionin e varësisë administrative.

25. Në zbatim të pikës 10, kapitulli IV, shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes" me ndryshimet përkatëse... nënkupton shfuqizimin edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.283, datë 18.6.1999 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk janë shitur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.284, datë 18.6.1999 "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.520, datë 14.11.1999 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.606, datë 16.12.1999 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, si dhe udhëzimi në zbatim të tyre.

26. Bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pasqyrat e vlerësimit nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003, si dhe pasqyra e koeficientëve të vendndodhjes.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e Fletores Zyrtare.

AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT MINISTRIA E EKONOMISË
DREJTOR I PËRGJITHSHËM MINISTRI
Zihni Beqiraj Arben Malaj

Pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.159, datë 13.3.2003, botuar në Fletoren Zyrtare nr.20.

Vendndodhja e objekteve të paluajtshme	Shtesa	Pakësime
a) Në rrethet ose qytetet Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Vlorë ose në qendrat e banuara turistike ku përfshihen zonat e përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 "Për miratimin e zonave që kanë përparësi në zhvillimin e turizmit".		
- Zonat e thella malore joturistike	-	30%
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a)	15%	-
- Brenda vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a), përveç pjesëve që përfshihen më poshtë	50%	-
- Në rrugët kryesore dhe segmente rrugësh me trafik të dendur (Rr.K.S.T.D) të qyteteve Fier, Lushnjë, Berat, qendrat e banuara të përshkruara në pikën (a).	60%	-
- Në Rr.K.S.Rr.T.D të qyteteve Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Pogradec, Sarandë.	70%	-

b) Në rrethet ose qytetet Delvinë, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Laç ose Lezhë.		
- Në zonat e thella malore joturistike		50%
Brenda vijave kufizuese të qyteteve (pika b)	35%	
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika b)		
- Rr.K.S.Rr.T.D të qyteteve të pikës b.	50%	
c) Në rrethet ose qytetet e Devollit, Kolonjës, Mallakastrës, Peqinit, Tepelenës, Peshkopisë, Kukësit, e Përmetit dhe qytetet e qendrat e tjera me 10-20 mijë banorë.		
- Në zonat e thella malore joturistike	-	55%
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)	-	20%
- Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)		
-Rr.K.S.Rr.T.D në qendrat e qendrat (pikës c)	10%	-
d) Në rrethet ose qytetet Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tropojë e qendra të tjera nën 10 000 banorë.		
-Në zonat e thella malore joturistike	-	70%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)	-	25%
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)	-	20%
-Rr.K.S.Rr.T.D në qytet e qendra (pika d)	-	15%
e) Në zonat e pikat doganore	35%	-

Ndërmarrja _____
Institucioni _____
Objekti _____

PASQYRA NR.1

Gjendja faktike e mjeteve kryesore dhe vlerësimi i tyre në kohën e përfundimit të vlerësimit

Nr	Emërtimi	Vl.fillestare ndërtim, prodhim apo çmimi i bler.sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit 000/lekë	Amortizimi për investimet në 000/lekë	Vlera e mbetur në 000/lekë		Vlefte e korrigjuar me idenksin e çmimeve	Vlera e korrigjuar me koeficientin e vendndodhjes	Sipërfaq.m2	
				V.fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit	Vlefte e llogaritur me grup ekspertësh			Gjithsej	Nga kjo nënobjekt
	a	b	c	ç	d	e	f	g	h
1	Ndërtesa gjithsej								
2	Instal.Pajisje								

	transmesio ni								
3	Makineri e pajisje energjetike								
4	Makineri e pajisje pune								
5	Instrument a e vegla								
6	Mjete transporti								
7	Kafshë pune e prodhimi								
8	Kultura drufrutore								
9	Inventar ekonomik								
10	Të tjera								
	Shuma								
11	Vlefte e tokës								
	Totali								

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet nga komisioni i vlerësimit duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve e procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

Ndërmarrja _____

Institucioni _____

Objekti _____

PASQYRA NR. 2

Gjendja faktike dhe vlerësimi për çdo objekt në kohën e përfundimit të vlerësimit

Emërtimi	Viti I		Vl.fillest are e prodh. apo çmimit të blerjes sipas kontabilit etit ose vlerësimi t të bërë nga komision	Amorti zimi sipas kontabi litetit për investi met në 000/lek ë	Vlefte e mbetur në 000/lekë		Vlefte e llogarit ur me koefici e- ntin e çmime ve	Vlefte e llogarit ur me koeficien tin e vend- ndodhjes	Sip.m2	
	Ndërti mit, prodhi mit ose blerjes	Vënies në shfrytëzi m			Vl.fille stare minus amortiz imin sipas kontabi litetit	Vlefte e llogarit ur me grup eksper- tësh			Gjith sej	Nga kjo nën objekt

			i i vlerësimi t 000/lekë							
a	b	c	ç	d	e	f	g	m	o	q
I.Vleftha e objektit										
Nga këto:										
1.Mjete kryesore										
a)Ndërtim montime										
b)makineri pajisje										
c)Inventar ekonomik										
ç)Të tjera										
2)Mjete xhiro										
3.Toka										
Shuma										

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet nga komisioni i vlerësimit duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve e procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

Ndërmarrja _____
Institucioni _____
Objekti _____

PASQYRA NR.3

Gjendja faktike dhe vlerësimi i mjeteve të xhiros (pa likuiditetet në kohën e përfundimit të vlerësimit)

Nr.	Emërtimi	Grupi A	Grupi B	Grupi C
		Me vlerë aktuale kontabël jo më shumë se vlera në tregun aktual	Me vlerë kontabël në kohën e blerjes jo më shumë se vlera në tregun aktual	Me vlerë kontabël x koeficientin 0.1
	a	b	c	d

1. Lëndë të para e materiale kryesore
2. Materiale ndihmëse
3. Lëndë djegëse
4. Pjesë ndërrimi
5. Ambalazhe

6. Inventar i imët në depo
7. Inventar i imët në përdorim
8. Prodhim në proces
9. Produkte të gatshme në magazinë
10. Mallra

Shuma

Gjithsej: _____

Nga këto:

- a) Stoque
- b) Me qarkullim të ngadalshëm

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet bazuar në llogaritë analitike të mjeteve zhbirues, dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël, inventarizimit fizik për çdo element të tyre, si dhe rivlerësimit me çmimet e liberalizuara të tregut të lirë duke i grupuar sipas pasqyrës së mësipërme.

Ndërmarrja _____

Institucioni _____

Objekti _____

PASQYRA NR.4

Gjendja financiare e ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet në kohën e përfundimit të vlerësimit

Të ardhurat			Detyrimet		
Nr.	Emërtimi i llogarive	Vlefte 000/lekë	Nr.	Emërtimi i llogarive	Vlefte 000/lekë
Shuma:			Shuma:		

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Ndërmarrja _____
 Institucioni _____
 Objekti _____

PASQYRA NR.5

Gjendja faktike dhe vlerësimi i investimeve në proces, në momentin e përfundimit të vlerësimit

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Vlefte fillestare e ndërtimit, prodhimit ose çmimi i blerjes sipas situacionit e dokumenteve të tjera kontabël		Vlefte e shitjes e llogaritur me koeficientin e vendndodhjes	Sipërfaqja	
		Para korrigjimit	Pas korrigjimit me ind.e çmimit		Gjithsej	Nën objekt
	a	b	c (b x indx)	ç (c+shtesë)	d	e

1.Vlefte gjithsej

Nga këto:

1. Ndërtim montime
2. Makineri pajisje
3. Investime të tjera
4. Studime
5. Mjete xhiruese pranë objektit
6. Vlefte e tokës

Shuma: _____

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Të dhënat për plotësimin e kësaj pasqyre të merren nga situacioni i ndërtimit të objektit të dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, si dhe llogaritjet e matjet e bëra direkt nga komisioni i vlerësimit. Kolona "C" tregon vlerën fillestare të korrigjuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

Ndërmarrja _____
 Institucioni _____
 Objekti _____

PASQYRA NR.6

Të dhënat ekonomiko-financiare të ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet		
			Paraardhës	Ekzistues	Parashikues
1	Sipërfaqja e objektit dhe ambienteve që disponon ndërmarrja	m2			
2	Sipërfaqja e tokës e punuar	m2			
3	Vëllimi i prodhimit industrial i shitur	000/lekë			
4	Vëllimi i prodhimit bujqësor	000/lekë			
5	Volumi i punimeve SMT	000/lekë			
6	Volumi i riparim shërbimeve meremetimeve	000/lekë			
7	Volumi i transportit të mallrave	000/lekë			
8	Volumi i ndërtim monumenteve	000/lekë			
9	Qarkullimi i mallrave gjithsej	000/lekë			
10	Vëllimi i investimeve	000/lekë			
11	Importi gjithsej (çmimi i blerjes)	000/lekë			
12	Eksporti gjithsej (çmimi i shitjes)	000/lekë			
13	Numri i punonjësve	000/lekë			
14	Fondi i pagave	000/lekë			
15	Fitimi gjithsej Nga ky: i derdhur në buxhet	000/lekë 000/lekë			
16	Humbje gjithsej	000/lekë			
17	Gjendje financiare	000/lekë			

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Të dhënat për plotësimin e kësaj pasqyre të merren nga situacioni i ndërtimit të objektit të dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, si dhe llogaritjet e matjet e bëra direkt nga komisioni i vlerësimit. Kolona "C" tregon vlerën fillestare të korrigjuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

Ndërmarrja _____
Institucioni _____
Objekti _____

PASQYRA NR.7

Disa tregues përmbledhës të ndërmarrjes ose të institucionit që do të privatizohet:

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Në kohën e përfundimit të vlerësimit	Vërejtjet
1	Vlefë e shitjes së mjeteve kryesore	000/lekë		
2	Vlefë e shitjes së mjeteve xhiruese	000/lekë		
3	Vlefë e shitjes së investimeve në proces	000/lekë		
4	Shuma 1-2-3			
5	Fitimi për një punonjës			
6	Humbja për një punonjës			
7	Kërkesat e paraqitura për privatizim			
	Nga këto:			
	- Blerje direkte			
	- Aksione			
	- Ankand			
8	Vlera e shitjes ose e dhënies me qira të tokës			

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

UDHËZIMI PËRBASHKËT

Nr.2, datë 9.5.2003

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT
TË MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT
PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË
AKSIONEVE NË SHOQËRITË TREGTARE**

Në zbatim të vendimit nr.119, datë 27.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, Ministri i Ekonomisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit

UDHËZONJË:

1. Në udhëzimin e përbashkët të AKP- së dhe Ministrisë së Ekonomisë për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000 në kapitullin e I-rë, germa A pika 2 shtohet nën-pika 1, me këtë përmbajtje:

1) Aktin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, së bashku me hartën treguese.

2. Në kapitullin e II-të “Procedurat për përcaktimin e formulës së privatizimit nga AKP-ja”, germa A pika 1, shfuqizohet dhe formulohet si më poshtë:

1) Sektori i privatizimit të shoqërive tregtare dhe ndërmarrjeve strategjike, pasi gjen të rregullt

konform vendimit nr.119, datë 18.3.2000 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 27.2.2003, dokumentacionin e dërguar nga Ministria e Ekonomisë përgatit materialin që do të publikohet sipas elementeve të përcaktuara në pikën 2 germa A të kapitullit të I-rë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000.

3. Po në këtë kapitull shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

2) Sektori i privatizimit të shoqërive tregtare dhe ndërmarrjeve strategjike përgatit materialin për t'u publikuar në faqen e internetit të AKP-së, i cili përmban përveç elementeve të publikimit dhe treguesit tekniko-ekonomik të shoqërisë sipas bilancit të vitit të fundit. I njëjti material dërgohet për t'u njoftuar në radio dhe televizion.

4. Pika 2 emërtohet pika 3 dhe formulohet si më poshtë:

3) Materiali i publikimit u dërgohet degëve të AKP-ve për vendosjen e afisheve pranë shoqërive që privatizohen, si dhe në mjediset publike të vendndodhjes së subjektit.

5. Pika 3 dhe 4 emërtohen respektivisht pika 4 dhe 5.

6. Në kapitullin e III-të të udhëzimit "Procedurat për zbatimin e kapitullit të II-të të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000" shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5) Sektori i privatizimit të shoqërisë tregtare dhe ndërmarrjeve strategjike menjëherë me fillimin e procedurave të publikimit të shitjes për paketat e aksioneve shtetërore në shoqëritë pjesërisht të privatizuara, njofton shoqërinë dhe këshillin mbikëqyrës së saj për organizimin e mbledhjes së aksioneve në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" për prononcimin zyrtar të aksionerëve për blerjen e paketës së aksioneve me çmimin e arritur në ankand.

7. a) Ish-pronarët e truallit si subjekte kërkuese në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, ndryshuar me akte të tjera kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuara në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit, të përcaktuar sipas vendimit nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve dhe ndërmarrjeve shtetërore që u nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare".

Në pikën 7 të këtij vendimi rivlerësimi i truallit në shoqëritë tregtare me kapital 100 për qind shtetëror, trualli do të rivlerësohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 13.3.2003 të cituar më sipër. Shtimi i vlerës së truallit në bilancin e shoqërisë, në aktivin e saj do të reflektohet si shtesë në kapitalin e shoqërisë.

b) Për shoqëritë anonime pjesërisht të privatizuara të cilat janë transferuar aksionet e ish-pronarëve të truallit, ky vendim nuk merr përsipër të bëjë kompensim.

c) Për shoqëritë anonime pjesërisht të privatizuara, të cilat nuk janë transferuar aksionet e ish-pronarëve të truallit, rritja e vlerës së truallit sipas vendimit nr.169, datë 13.3.2003 do të vendoset në mbledhjet e jashtëzakonshme të asamblesë së aksionerëve të shoqërive në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" duke zbatuar dispozitat e seksionit të 6-të, nënseksioni "Zmadhimi i kapitalit".

Në këtë rast ish-pronarët e truallit:

- kanë të drejtë të marrin aksione në përpjesëtim me vlerën e truallit të llogaritura sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 13.3.2003 vetëm në rast se vendoset zmadhimi i kapitalit në mbledhjen e jashtëzakonshme të aksionerëve me votat që kërkohen për ndryshimet në statut;

- do të paguhet në cash, në rast se në asamble vendoset që vlera e rivlerësuar e truallit të pasqyrohet në pasiv të bilancit, si detyrim i shoqërisë.

d) Në rast se në mbledhjen e asamblesë nuk vendoset zmadhimi i kapitalit dhe lënia si detyrim i shoqërisë për shlyerje të ish-pronarëve për vlerën e rritur të truallit, atëherë ish-pronarët:

- do të kompensohen duke kaluar në favor të tyre për aq sa i takon, pjesë nga paketa e mbetur e aksioneve shtetërore në shoqëritë anonime;

- ose do të kompensohen me njërin nga format e kompensimit, të përcaktuara me ligj.

8. Për pikën 12 të vendimit sqarohet se ripublikimi do të bëhet edhe në rast se në ankand paraqitet një kërkesë e vetme.

9. Për pikën 13 të projektvendimit: Në qoftë se mbas dy publikimeve të AKP-së për shitjen e paketave të aksioneve nuk paraqitet asnjë kërkesë, atëherë shoqërisë mund t'i bëhet një vlerësim nga një grup ekspertësh të pavarur kontabël dhe vlerësues pasurie të emëruar me urdhër të Ministrit të

Ekonomisë. Vlerësimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ta ofruar shoqërinë për shitje nëpërmjet sugjerimit të vlerës reale, gjë që do të vendosë pritshmërinë e shitjes.

Rekomandohen si metoda më bashkëkohore vlerësimi: vlera e kapitalizuar e shoqërisë duke reflektuar në kapitalin themeltar shtesat ose pakësimet e zërave brenda kapitaleve të veta të shoqërisë; vlera aktuale e tregut nëpërmjet shitjeve krahasuese; pasqyra e cash-it; treguesit e performancës etj.

Me paraqitjen e raportit të ekspertëve për këtë vlerësim Ministri i Ekonomisë urdhëron privatizimin nëpërmjet ankandit të paketës shtetërore të aksioneve.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Zihni Beqiraj

MINISTRI I EKONOMISË
Arben Malaj

U D H Ë Z I M
Nr.3, datë 30.5.2003

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.169,
DATË 13.3.2003 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES
SË TROJEVE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE,
QË I NËNSHTROHEN PRIVATIZIMIT OSE TRANSFORMIMIT TË TYRE NË SHOQËRI
TREGTARE”**

Në zbatim të pikës 1, kapitulli V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 13.3.2003 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregëtare”, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit

U D H Ë Z O J N Ë:

1. Truall konsiderohet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale e tij përcaktuar në genplanin e objektit që është pjesë e dokumentacionit të privatizimit që përgatit komisioni i vlerësimit të ndërmarrjes sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 13.3.2003.

2. Kur ish-pronari i truallit është bërë pronar i objektit duke përdorur të drejtën e parablerjes sipas pikës 2, kapitulli III-të i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003, truall kalon në favor të tij pa shpërblim. Ndërsa kur ish-pronarët e truallit nuk kanë përfituar objekt në trojet ish-pronë e tyre, u lind e drejta e kompensimit fizik për të shlyer trojet e shitura, siç përcaktohet në nenin 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”.

3. Në rast se në një objekt figurojnë disa pronarë trualli, atëherë në bazë të kërkesës së tyre, truallit shitet në bashkëpronësi të pandarë në pjesë. Bashkëpronarët u nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil. Kur objekti është me 2 ose më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, përsëri shitja e truallit bëhet me bashkëpronësi të pandashme mes pronarëve të objektit.

Shembull:

- Objekti me 3 kate është ndërtura mbi një sipërfaqe 500 m² (sipërf.ndërtimi + mjedisin e përbashkët + sipërf. e bordurës + sipërfaqen e truallit në oborr, nëse ka).

- Sipërfaqja e ndërtimit, pa ambientet e përbashkëta është 1250 m² dhe për çdo kat është: kati I-rë 450 m²; kati II-të 450 m² dhe kati III-të 350 m².

Llogaritet koeficienti (k)

$$K = \frac{\text{Sipërfaqe trualli}}{\text{Sipërfaqe ndërtimi}} = \frac{500 \text{ m}^2}{1250 \text{ m}^2} = 0.4$$

Koeficienti është konstant, duke u shumëzuar me sipërfaqet përkatëse të ndërtimit që zë secili

pronar, jep sipërfaqen përkatëse që i takon të privatizojë secili pronar. Në një kat mund të jenë një ose më shumë pronarë. Në rastin tonë në shembull kemi vetëm nga një pronar në çdo kat. Konkretisht:

Për katin e I-rë $450 \text{ m}^2 \times 0,4 = 180 \text{ m}^2$

Për katin e II-të $450 \text{ m}^2 \times 0,4 = 180 \text{ m}^2$

Për katin e III-të $350 \text{ m}^2 \times 0,4 = 140 \text{ m}^2$

Këto sipërfaqe duke u shumëzuar me çmimin për m^2 të llogaritur nga seksioni i financës, japin vlef tën që duhet të paguajë në lekë secili pronar.

4. Në publikim, krahas VAM-it, do të përfshihet dhe vlef e truallit me sipërfaqen përkatëse. Vlef e shitjes së truallit nuk do të përfshihet në VAM. Në rast se në dosjen e privatizimit nuk gjendet dokumentacioni i plotë, i përcaktuar në pikën 1, 2 dhe 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003, atëherë u kërkohet degëve të shoqërive publike, sipas përkatësisë së ndërmarrjes, brenda 2 muajve nga dalja e këtij udhëzimi, të saktësojnë dhe plotësojnë dokumentacionin.

5. Në rastet kur një ndërmarrje është privatizuar ose do të privatizohet të mbahet parasysh ndarja e sipërfaqes së truallit që shërben për rrugë kalimi të përbashkëta. Në këtë rast sipërfaqja e truallit do të shitet në bashkëpronësi në mes tyre në raport me sipërfaqen që ato kanë në pronësi. Për këtë duhet të sjellim nga seksioni i urbanistikës së pushtetit vendor konfirmimin për përcaktimin e kësaj sipërfaqeje në bashkëpronësi.

6. Në zbatim të kapitullit III pika 4, kur pronari i ri i ndërmarrjes ose objektit të privatizuar, dëshiron të blejë truallin e ndërmarrjes ose objektit përkatës, atëherë në kërkesën e tij për blerjen e ndërmarrjes ose objektit duhet të shprehet edhe për blerjen e truallit të tij.

Kur pronari i ri i ndërmarrjes nuk dëshiron të blejë truallin e ndërmarrjes ose objektit përkatës, atëherë ai depoziton kërkesën me shkrim në momentin e përfundimit të ankandit ku shprehet se nuk dëshiron të blejë truallin e ndërmarrjes ose objektit, ndërkohë është i detyruar të nënshkruajë një kontratë vjetore të qirasë së truallit me seksionin e financës të organit të qeverisjes vendore, kontratë e cila do të jetë pjesë përbërëse e kontratës noteriale të shitjes së ndërmarrjes ose objektit.

7. Në zbatim të kapitullit IV-t pika 2/d, data e deklaratës noteriale origjinale, që blerësi nuk ka proces gjyqësor për objektin dhe truallin përkatës që kërkon të blejë, duhet të jetë jo më parë se një ditë, nga dita e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit.

8. Në zbatim të kapitullit IV-t pika 9, blerësi që kërkon të blejë truallin e ndërmarrjes ose objektit të privatizuar sipas autorizimit përkatës të kalimit të pronësisë, para lidhjes së kontratës së shitjes, duhet të paraqesë pranë AKP-së:

a) dokumentin bankar origjinal, që vërteton pagesën e vlerës së plotë të truallit;

b) vërtetimin e pagesës së plotë të qirasë së truallit deri në momentin e pagesës së vlerës së plotë të truallit, të konfirmuar nga seksioni i financës së organit të qeverisjes vendore.

TË PËRGJITHSHME

1. Në zbatim të kapitullit të V-të pika 3, nuk do të zbatohen procedurat e vlerësimit të trojeve të objekteve si më poshtë:

a) trojet e atyre objekteve të cilat kanë përfunduar privatizimin, dhe formularin e llogaritjes së truallit e kanë në dosjen e privatizimit;

b) trojet e atyre objekteve që janë të dërguara në Ministrinë e Ekonomisë një ditë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe që kanë formularin e vlerësimit të truallit në dosje;

c) trojet e atyre objekteve për të cilat kërkesa për blerje është depozituar në AKP ose degët e saj në prefektura një ditë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Në rastet ku mungon dosja e privatizimit të objektit për arsye objektive pranë AKP-së ose degëve të saj, kopja e dosjes së vlerësimit (privatizimit) të objektit ose ndërmarrjes kërkohet nga degët e shoqërive publike, ZRPP-ve në juridiksionin e së cilës ndodhet objekti ose zyra noteriale. Kur edhe aty nuk gjendet dosja e vlerësimit (privatizimit), atëherë AKP-ja kryen procedurat e privatizimit të truallit mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga pronari i objektit, (kontrata e shitjes së ndërmarrjes ose objektit, akti i dorëzimit, autorizimi për kalim pronësie, genplani, mandatpagesat etj.), të njohura këto me vendim gjyqësor të shkallës së parë të formës së prerë.

3. Ky udhëzim hynë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

AGJENCIA KOMBËTARE
E PRIVATIZIMIT
DREJTORI I PËRGJITHSHEM
Zihni Beqiraj

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT

Ben Blushi

MINISTRI I EKONOMISË
Arben Malaj

U D H Ë Z I M
Nr.4, datë 11.6.2003

**PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003 "Për dhënie me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore", Ministri i Ekonomisë nxjerr këtë

U D H Ë Z I M:

1. Pasuritë e ndërmarrjeve, shoqërive me kapital shtetëror dhe institucionet shtetërore jepen me qira me konkurrim nga organi që ka të drejtën e lidhjes së kontratës.

2. Përfshihen nga konkurrimi:

- objektet me sipërfaqe deri në 200 m² ;
- objektet të cilat jepen me qira pas pajisjes së tyre nga organet kompetente të lëshimit të licencave minerare, peshkimit, ujore etj.

Në këto raste, lidhja e kontratës bëhet me çmim dysHEME duke plotësuar kriteret e veçanta të miratuara prej ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore.

3. E drejta e lidhjes së kontratës së qirasë do të jetë:

a) Për sipërfaqe deri në 200 m² lidhja e kontratës bëhet nga organi drejtues i ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit për një afat deri 1 vit. Për dhënie me qira mbi këtë afat merret miratimi i organit të varësisë administrative dhe procedura e qiradhënies i nënshtrohet konkurrit, njësoj si për objektet e grupit (b).

Dhënia me qira e pasurive të ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit, për të cilat është bërë kalimi i përfaqësuesit të pronarit shtet të pushtetit vendor, bëhet pasi merret miratimi i këtij të fundit.

b) Për sipërfaqe 201 deri 500 m² lidhja e kontratës bëhet nga organi që ushtron të drejtën e varësisë administrative të ndërmarrjes për një afat deri 5 vjet. Për dhënie me qira mbi këtë afat merret miratimi i organit që ushtron të drejtën e pronarit shtet të ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit.

Lidhja e kontratës për dhënie me qira të pasurive të ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit, për të cilat është bërë kalimi i përfaqësuesit të pronarit shtet te pushteti vendor, bëhet me miratimin e këshillave përkatëse të bashkive, komunave, qarqeve.

c) Për sipërfaqe mbi 501 m² lidhja e kontratës bëhet nga organi që ushtron të drejtën e pronarit shtet të ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit për një afat deri 20 vjet.

Organi i pushtetit vendor lidh kontratën e qirasë për pasuritë e ndërmarrjes, shoqërisë e institucionit për të cilat ushtrojnë të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore me miratim të këshillit bashkiak, të qarkut ose të komunës.

4. Konkurrimi për sipërfaqet mbi 201 m² bëhet në përputhje me elementet e konkurrit të miratuara në pikën 2 të vendimit:

- kur objektet jepen për qëllim zhvillimi veprimtarie prodhuese,
- për shërbime.

Kritere shtesë mund të caktohen nga institucionet qendrore dhe vendore për dhënie me qira të mjediseve brenda ndërtesave të tyre, si dhe për ato të karakterit kombëtar me qëllim ruajtjen e vlerave muzeale, historike, arkeologjike etj.

5. Ndërmarrja, shoqëria ose institucioni shtetëror përgatit dokumentacionin për objektet, pasuritë e saj, që do të japë me qira: genplanin e sipërfaqeve të objekteve ndërtesë dhe të sipërfaqeve të lira funksionale, vlerësimin e truallit të lirë apo funksional, vlerësimin e qirasë së makineri-pajisjeve, certifikatën e regjistrimit të pronësisë shtetërore të objektit në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme ose një vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që objekti nuk është në pronësi private, por shtetërore, si dhe miratimin e saj për qiradhënie.

Për objekte me sipërfaqe mbi 201 m² dokumentacioni dërgohet në organin që ushtron të drejtën e varësisë administrative, dhe ky i fundit për sipërfaqet mbi 501 m², pasi e plotëson, e dërgon në Ministrinë e Ekonomisë.

Ndërmarrja, shoqëria ose institucioni shtetëror dhe organet e varësisë administrative propozojnë edhe afatin, qëllimin, si dhe kriteret të tjera specifike për objektin që do të jepet me qira.

6. Procedurat e publikimit të objektit që do të jepet me qira fillojnë me urdhër të drejtuesit të organit, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës. Publikimi bëhet, si rregull, nga organi që ka të drejtën e lidhjes së kontratës.

Në urdhër caktohet që publikimi për sipërfaqe mbi 201 m² mund të bëhet edhe nga vetë ndërmarrja, shoqëria dhe institucioni shtetëror sipas kriterëve të miratuara në urdhër, por dokumentacioni të dorëzohet prej subjekteve në organin që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë.

Në urdhër jepet: vlera dysHEME e qirasë, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, përbërja e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit të konkurrentëve, qëllimi i dhënies me qira, afati, data, ora dhe vendi i saktë i mbledhjes së komisionit, si dhe i dorëzimit të kërkesave nga subjektet konkurruese.

7. Hapja e zarfit për çmimin e ofruar të qirasë dhe shqyrtimi i dokumentacionit bëhet në prani të konkurrentëve. Konkurrentëve u kthehet dokumentacioni, nëse ai rezulton jo i rregullt, duke i përjashtuar nga konkurrimi.

Komisioni pasi shqyrton dokumentacionin, bën vlerësimin e tyre, harton procesverbalin e mbledhjes dhe i propozon titullarit të organit që ushtron të drejtën e lidhjes së kontratës, subjektin fitues.

8. Lidhja e kontratës së qirasë bëhet me autorizim të titullarit të organit që ushtron të drejtën e lidhjes së kontratës të miratuar në pikën 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 24.4.2003. Çdo ndryshim i kushteve të kontratës bëhet me miratim të titullarit që ka autorizuar lidhjen e kontratës.

9. Me nënshkrimin e kontratës, qiramarrësi bën pagesën e garancisë së kontratës, të barabartë me vlerën 3-mujore të qirasë. Kjo qëndron në llogarinë e qiradhënësit deri në përfundim të kontratës, ndërsa për kontratat me sipërfaqe mbi 501 m², në marrëveshje midis palëve, garancia qëndron deri në përfundim të kontratës ose të përfundimit të investimeve të marra përsipër nga qiramarrësi.

10. Llogaritja e vlerës së qirasë për ndërtesat me dy e më shumë kate bëhet duke mbledhur shumën e sipërfaqeve të çdo kati dhe duke e shumëzuar me tarifën e qirasë për m².

11. Kur ndërmarrja, shoqëria ose institucioni që ka ambiente të dhëna me qira shitet, publikimi për shitjen e tyre bëhet duke përfshirë edhe kontratat e qirasë. Në procesverbalin e dorëzimit të objektit, së bashku me pasurinë që shitet transferohen edhe kontratat e qirasë. Blerësi është i detyruar të respektojë afatin dhe kushtet e tjera të kontratës së qirasë.

12. Monitorimi i kontratave të qirasë apo enfiteoze bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.461, datë 6.10.1999 “Për monitorimin e objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore të dhëna me qira apo enfiteoze dhe përdorimi i të ardhurave nga qiratë apo enfiteoza”.

13. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Arben Malaj

V E N D I M
Nr.134, datë 30.4.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “ALFA”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ALFA” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Alfa” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetive të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas dhënies së lejes nga ERT-ja dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.135, datë 30.4.2003
PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “LUSHNJA”
SUBJEKTIT: Z.SULEJMAN LESHI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit z.Sulejman Leshi, me vendndodhje në qytetin e Lushnjës, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kallbor privat, në fushën e transmetive të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas dhënies së lejes nga ERT-ja dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
(I SHKURTUAR)

Gjykata e Shkallës së Parë të Kukësit shpall të zhdukur shtetasin Ilir Arben Driza, i datëlindjes 1971, lindur dhe banues në Kukës.

KËRKUESE
Ajshe Driza

KËRKESE

Majlinda Koçi, banuese në lagjen 10 korriku Vlorë, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Qemal Veizi.

KËRKUESE
Majlinda Koçi

KËRKESE

Xhuljeta Telo Xhemali, banuese në Durrës, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Qani Xhemali.

KËRKUESE
Xhuljeta Xhemali

NDREQJE GABIMI

Në ligjin nr.8991, datë 23.1.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, shkurt 2003 (faqe 157), në nenin 9 pika 10 hiqen fjalët “për miratim në KKRT.”

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 12.6.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë